



## **Kërkesë për punësim: Drejtues të Komunikimit dhe PR**

SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti", në kuadër të procesit të plotësimit të personelit kërkojmë të punësojmë **Drejtues të Komunikimit dhe PR.**

### **Kandidati duhet të përmbushë këto kritere:**

- Të jetë i diplomuar (preferohet në një nga vëndet e BE-së) në fushën e Gazetarisë / Shkencave Sociale/ PR;
- Preferohet të ketë gradën shkencore "Doktor";
- Eksperiencë pune, të paktën 5 vite në pozicione të ngjashme;
- Të ketë eksperiencë në mësimdhënie / trajnime;
- Të ketë përvojë në kërkimin shkencor;
- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në një projekt me shumë partnerë ndërkombëtarë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve;
- Njohje shumë të mirë të gjuhës angleze dhe italiane;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Paketa Office etj).

### **Qëllimi i pozicionit:**

Të drejtojë dhe menaxhojë, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Marketingut dhe Eventeve, si edhe me zyrat e tjera të Universitetit, aktivitetet që lidhen me imazhin dhe komunikimin e shërbimeve të Universitetit, ku përfshihen: marketimi i fushatës së rekrutimit; sigurimi i pozicionimit të saktë të markës së Universitetit në treg; identifikimi dhe komunikimi i qartë i vlerave të markës në treg; etj.

### **Aktivitetet kryesore**

- Në bashkëpunim me zyra të tjera të Universitetit, të identifikojë dhe përshkruajë qartë pozicionimin e markës institucionale.
- Të identifikojë dhe shkruajë mesazhet e qarta që do të vendosen në të gjitha portalet / materialet promovuese / publikime të Universitetit.
- Të sigurohet për një shpërndarje të saktë të materialeve që mbartin markën institucionale në kanalet e posaçme të komunikimit (Media Plan).
- Të sigurohet për cilësinë e komunikimeve në kanalet e Mediave Sociale të Universitetit (*website, facebook, instagram, youtube, tëitter dhe linkedin*).
- Në bashkëpunim me zyrat e tjera të Unviersitetit, të jetë përgjegjës për hartimin e strategjisë afatgjatë të Imazhit të Universitetit (plan 5 vjeçar).
- Përgjegjës për vendosjen dhe menaxhimin e buxhetit të komunikimit në media dhe shpërndarjen e saktë të tij në periudha dhe procese të caktuara, gjatë një viti.



- Në bashkëpunim me Zyrën e Rekrutimit, të jetë aktiv dhe proaktiv në procesin e rekrutimit, si edhe në identifikimin e tregjeve të reja / mundësive të reja rekrutuese.
- Të mbështesë zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë për krijimin e materialeve promovuese që lehtësojnë komunikimin me Universitetet / Partnerët Ndërkombëtarë.
- Të krijojë dhe mirëmbajë formate të brëndshme komunikimi dhe procedura për mbarëvajtjen e punës me zyrat e ndryshme brënda Universitetit dhe grupin e punës.
- Të jetë i / e gatshme të punojë në grupe të ndryshme dhe të ndërmarrë detyra të tjera të ngarkuara nga Administratori / Administratori i deleguar i Universitetit.
- Të jetë i aftë të lektorojë lëndë në fushën e Marketingut dhe Komunikimit me fokus në ATL.
- Të bashkëpunojë ngushtë me Institutet Kërkimore brenda Universitetit për projekte aktuale dhe potenciale.
- Të ketë aftësi të mira kërkimore shkencore.

#### **Procedura e aplikimit:**

Kandidatët aplikues, **deri në datën 8 janar 2020**, duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në "Universiteti Marin Barleti" (në formë të printuar) si dhe në adresën elektronike [hr@umb.edu.al](mailto:hr@umb.edu.al), dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kopje të noterizuar të diplomave dhe listës së notave të studimeve universitare dhe pasuniversitare;
- Një CV të përditësuar, në gjuhën shqipe dhe angleze, në formatin Europass;
- Një letër interesi për pozicion për të cilin aplikon;
- Dy kontakte reference. (opcionale)

Vetëm personat që plotësojnë kriteret e vendosura më sipër do të kontaktohen.

Të dhënat e aplikantëve mblidhen, përpunohen dhe trajtohen në mënyrë konfidenciale në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".